



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
OPERATORI I SHËRBIMEVE TE KUJDESIT SHËNDETËSOR  
SPITALI RAJONAL SHKODËR

MIRATOHET  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SENAD HALLUNAJ

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Me date 24.05.2024 njesia e prokurimit e perbere nga Ing. Islam Canga, Redona Haxhijaj, Ervin Anamali te ngritur me urdher prokurimi nr 26 date 24.05.2024 në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** harton proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit:

**Procedure e hapur e thjeshtuar** ” pasi fondi limit është nën kufirin e ulët monetar për shërbime. Kjo lidhur me fondin e Përlllogaritur dhe specifikimet perkatese I cili është bërë me shkresën nr 131/1 prot date 23.01.2024. Me objekt **Riparim, mirëmbajtje automjetesh- Marreveshje Kuader** - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj, me kod(CPV Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash 50112000-3 , me fond limit 6,306,405.64 (gjashtëmiljon e treqind e gjashtëmijë e katërqind e pesë .64) leke pa TVSH

Njesia e prokurimit lidhur me procedurën ka hartuar kriteret me përmbajtje si më poshtë:

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se:

- 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
- 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

**Argumentimi:** Kjo shtojce është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituara.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha shtojcat sipas DST-vetë tenderit që janë Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik (Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1, Lista e cmimeve të artikujve sipas shtojcës 2).

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1**, për veprimtarinë “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” në QKL **ne lidhje me objektin e prokurimit** .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, **Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*). Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e

bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori Ekonomik te paraqese deklarate se disponon ambiente (servis) në pronesi ose me qera ne qytetin e Shkodres per ushtrimin e aktivitetit të tij sipas objektit te prokurimit.

- Për ambjentin në pronesi duhet të paraqesë Çertifikaten e Pronësisë të lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj.
- Për ambjentin me qera duhet të paraqese kontrate qeraje origjinale e noterizuar e vlefshme gjatë gjithë kohe zgjatjes së kontratës shoqëruar me Çertifikaten e Pronësisë të qiradhënesit.
- Ambientet e ushtrimit të aktivitetit në pronesi ose me qera të jenë të pasqyruara në Ekstraktin e QKB-së.

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” AK kërkon që OE duhet të disponojë servis për riparimin e automjeteve, kërkesë e cila është e domosdoshme vendi dhe adresa ku automjetet e AK do të paraqiten sipas planifikimit për të realizuar shërbimet që parashikohen dhe riparimet e difekteve të rastit për çdo rast të nevojshëm por më e rëndësishme është për të krijuar e besueshmerine në realizimin me sukses të kontrates

Bazuar në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Ambientet e ushtrimit të aktivitetit në pronësi ose me qera të jene të pasqyruara në Ekstraktin e QKB-së.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë **minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:**

- 1 (një) motorrist;
- 1 (një) xhenerik;
- 1 (një) elektroauto

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- kontratat individuale të punës me afat vlefshmerie për të gjithë kohezgjatjen e kontrates
- Diplomë ose Çertifikatë/deshmi kualifikimi për objektin e prokurimit në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Listepagesa e deklaruara në organet tatimore (formulet E-sig 025 ) për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Punonjesit të jene të deklaruara bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listes kombetare të profesioneve”.

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjisllacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë

profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Stafi i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen

#### 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, të paktën:

- **1 (një) Inxhinier mekanik** në detyrën rolin e drejtuesit teknik.

Për punonjësin drejtuesi teknik, OE duhet të paraqese

- diplomë perkatëse si dhe
- kontratën e punës me afat vlefshmerie për të gjithë kohezgjatjen e kontrates ku të jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik
- Listepagesa e deklaruar ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.Punonjesit të jene të deklaruar bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listes kombetare të profesioneve”.

***Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen.

2.3.5 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për realizimin e objektit të prokurimit në ambientet (servis) në pronesi ose me qera në qytetin e Shkodrës për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) paisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit
- b) paisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;
- c) paisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;
- d) paisje urë ngritese për automjetet
- e) paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- f) paisje për kontrollin të sistemit të ushqimit.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Deklarate nga operatori ekonomik qe disponon keto mjete gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates shoqeruar me fotot perkatese te te gjitha pajisjeve.

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi :** Kërkesa që OE duhet të paraqesë një deklaratë per disponimin e paisjeve shoqeruar me foto është vendosur duke patur parasysh zërat e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike dhe vendimin e KPP-se nr 255/2021.

- a) paisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit
- b) Paisja kompjuterike diagnostikuese është një mjet i domosdoshëm për diagnostikimin e defekteve e cila kursen shumë kohë dhe përcakton me saktësi defektin apo pjesën e këmbimit e cila duhet ndërruar.
- c) paisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C per diagnostikimin e sistemit te kondicionimit
- d) Për riparimin e automjeteve, ato detyrimisht duhet të ngrihen ne urë ngritese që të kryhet shërbimi i kërkuar
- e) paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit kerkohet per arsye se zerat e shërbimeve jane te lidhura me kete pike.
- f) paisje për kontrollin të sistemit të ushqimit per diagnostikimit e pompave te nafates injektoreve etj.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara ne zërat e riparimit te kërkuara ne Shtojcën 6.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të disponoje karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara

- Për karrotrecin në pronësi duhet të paraqese:
  1. Lejet e qarkullimit dhe certifikaten e pronesisë sipas ligjit ne fuqi.
  2. Certifikata e kontrollit teknik
  3. Policen e sigurimit te mjetit
  4. Taksat
- Për karrotrecin me qera/huapërdorje duhet të paraqese:
  1. Kontrate qeraje origjinale e noterizuar apo huapërdorje e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës shoqeruar me certifikaten e pronesisë
  2. Lejet e qarkullimit dhe certifikaten e pronesisë sipas ligjit ne fuqi.

3. Certifikata e kontrollit teknik
4. Policen e sigurimit te mjetit
5. Taksat

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te **specifikohen pikat e mësipërme.**, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.AK kërkon që OE duhet të disponojë një automjet karrotrec, i cili do të jetë i nevojshën nëse ndonjë prej automjeteve të AK gjatë aktivitetit ditor pëson ndonjëdefekt të mundshmë dhe si pasojë lind nevoja per dergimin e mjetit të servisi i OE kontraktor.

Sipas udhezimit nr.4 te Ministrisë se Infrastrukturës dhe energjisë datë 28.06.2019 dhe propozimit te Drejtorisë se Pergjithshme te transportit rrugor nr.17699 prot, date 21.09.2020 leja e qarkullimit eshte e barasvlefshme me certifikaten e pronesisë. Per makinat e pajisura me leje para ketij viti duhen leja e qarkullimit dhe certifikata e pronesise.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të deklaroje se pjesët e këmbimit qe do te perdoren duhet të ofrohen të reja, prodhim sipas CE dhe me garanci jo me pak se 1 vit nga data e montimit (furnizim-vendosje)

**Argumentimi:** Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane aftesite per te realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate qe merr persiper riparimin dhe mirembajtje (Difekte)te automjeteve qe jane ne sherbim 24/24 ore ne çdo vend qe ndodh difekti, gjate gjithe periudhes se zbatimit kontrates

**Argumentimi:** Në bazë nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane aftesite per te realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Klasifikimi I Riparimeve:**

- 1- Riparime profilaktike (pjeset e nderrimit qe zevendesohen me kohe pedorimi).

- 2- Riparime difektsh (zevendesim pjese nderrimi te konsumuara ).
- 3- Riparime te pergjithshme (kthimi I agregatit ne parametrat fillestar ).

Pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve duhet të plotësojnë specifikimet e mëposhtme:

**1** - Te jene te reja dhe te prodhuara ose te tregetuara nga kompani sistemi sistemi I menaxhimit te cilesise se te cilave eshte sipas standartit ISO 9001:2015 sipas llojeve te mjeteve dhe viteve te prodhimit te tyre.

**2** – Ne trupin e tyre duhet te jete I stampuar kodi I prodhuesit.

**3** - Agregatet / Paisjet / Pjeset e kembimit qe do te perdoren gjate riparimit te automjeteve duhet te ofrohen sipas afateve te garancise te dhena nga prodhuesi I automjetit ose nga distributore te autorizuar nga prodhuesi I automjetit dhe kerkohet te jete jo me pak se 1 vit nga data e daljes se automjetit nga riparimi.

**4** – Ne rast te difekteve qe mund te ndodhin ne periudhen e garancise per sherbimin e kryer , riparimi do te kryhet me shpenzimet e operatorit ekonomik fitues.

**5** – Vaji I motorrit te jete I certifikuar sipas standarteve nderkomtare ACEA, API ose standarteve komtare / nderkomtare ekuivalente me to.

**6** – Vaji I kutise se shpejtesise , ridotos,diferencialit dhe vaji hidraulik te jene te certifikuar sipas standarteve ACEA, API ose standarteve komtare / nderkomtare ekuivalente me to.

### **III - Afatet e kryrjes se sherbimit:**

- 1- Riparim profilaktik ( nderrim filtra dhe voji I motorrit), jo me shume se 4 ore.
- 2- Riparim profilaktik ( rrip faze/zinxhir motorri)kit,jo me pak se 8 ore.
- 3- Riparime xhenerike ( brenda nje sistemi), jo me shume se 8 ore .
- 4- Riparime xhenerike (me shume se nje system ) jo me shume se 16 ore.
- 5- Diagnostikim dhe riparime elektrike jo me shume se 4 ore.
- 6- Riparime capital, agregat motorri, jo me shume se 120 ore.
- 7- Riparime ne motor ( guarnicion testae, ndrrim fasho motorri) jo me shume se 24 ore.
- 8- Riparime te mesme jo me shume se 3 dite.
- 9- Riparime te pergjithshme jo me shume se 10 dite.
- 10- N eraste difekti te automjetit ne rruge operatori eshte I detyruar q eta transportoje ate me karotrec deri ne servisin e tij pavaresisht se ku ndodhet mjetei.
- 11- Opertori Ekonomik duhet te dorezoje prane Autoritetit Kontraktor pjeset e zevendesuara te automjeteve.
- 12- Cdo sherbim I kerkuar nga enti prokurus te shoqerohet me urdher pune dhe situacion



punimesh, te bashkengjitura me nje process verbal nga nenshkrimet e komisionit et kolaudimit I ngritur nga Drejtoria dhe nga sipermarresi I kontraktuar.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku percaktohet *Specifikimet teknike, siç percaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike percaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet* dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet: *Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:*

- *termat e referencës;*
- *grafikun e ekzekutimit;*
- *kërkesat për personelin kryesor;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

**NJËSIA E PROKURIMIT:**

- |                   |  |
|-------------------|--|
| - Ing Islam Canga | -P/Sek.Teknik                              |
| - Redona Haxhijaj | - Juriste/Sektori i Planifikim Prokurimeve |
| - Ervin Anamali   | - Sp/Sek.Kostos                            |